



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2023

VENDIM

Nr. 145, datë 28.03.2023

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE
TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU
USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**
(ndryshuar me vendimin nr. 234, datë 18.05.2023)

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Lazër Sallaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Neni 284/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Zgjidhje martesë dhe pasojave ligjore të saj”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi dhe Alda Sadiku, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}, etj.; Të paditur: Trashëgimtarët e të ndjerit {...}; Palë e tretë: {...}; Objekti: “Detyrim njohje pronar”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Thomaidha Roça dhe Ervin Sulaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkuar: {...}, etj.; Të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Fier, Rudi Laze¹, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Shfrytëzim i prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Nertil Dushku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje e funksionarëve publik”, mbetur në tentativë, etj., parashikuar nga neni 79/a e 22, 76 e 22, 278/1, 100/2 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Rudi Laze, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Pavlefshmëri absolute e kontratës së shitjes, etj.”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Hektor Sinanaj (relator), Laurent Fuçia dhe Dorina Stroka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet kundër të pandehurëve: {...}, etj.; Të akuzuar për kryerjen e veprave penale”Falsifikimi i dokumentëve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal; “Përkrahje të autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302 të Kodit Penal; “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Dorina Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kallëzues/Kërkuar: {...}, {...} dhe {...}; Objekti: “Pushim i procedimit penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës për shoqërinë përmbarimore {...}. Objekti i kërkesës: “Përrjashtim i gjyqtarës {...}”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gentiana Muçaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi nga i padituri në masën {...} lekë për pagesa të kryera padrejtësisht për shpërblimin e trajnimeve, supervizimin dhe mentorimin ndaj organizatës {...}, etj.”

¹ Ndryshuar me vendimin nr. 234, datë 18.05.2023

2. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Afërdita Maho, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: Operatori Ekonomik {...}; Objekti: “Shpërblimin e dëmit si rrjedhojë e situacionit të punimeve tëpakryera sipas volumeve të situacionuara, konkretisht: Shpërblimin e dëmit në vlerën {...} lekë pa TVSH nga kontraktori {...}” shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. {...} prot., datë 18.07.2019 me objekt: “Rehabilitimi i shkollës {...}”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gentiana Muçaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, çështjen administrative me Paditës{...} shpk; I paditur: {...}; Objekti: “Detyrimin e palës së paditur Bashkia {...} që të paguajë në favor të paditëses vlerën e shërbimeve/punimeve të përfituara, etj.”

4. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Afërdita Maho, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin në masën {...} lekë, si pasojë e likuidimit të punimeve të porealizuara sipas volumeve të situacionuara në tenderin “Rikonstruksioni i rrugës “{...}”, fshati Dardhë”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR